



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4617/2 prot.

Himarë, 11.10. 2023

Njoftim për konsultim publik

Titulli dhe kodi i projektaktit:

Miratimi i buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për buxhetin e vitit 2024, bashkia Himarë.

Takimi publik:

Konsultimet publike do të organizohen sipas kalendarit bashkëlidhur këtij njoftimi.

Të ftuar:

Të gjithë banorët e territorit të bashkisë Himarë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi, OJF, Media, Kryetarët e fshatrave dhe ndërlidhësit komunitarë, grupe vulnerabël, përfaqësues të shoqatës së personave me aftësi të kufizuar etj.

Pjesëmarrës nga bashkia:

Kryetar dhe këshilltarë të Këshillit bashkiak, Kryetari i bashkisë, Sekretarja e Këshillit bashkiak, Koordinatori për informim dhe konsultim publik, drejtues/punonjës nga Drejtoria e financës - Drejtoria juridike - Drejtoria e tatim-taksave, administratorët e Njësive Administrative, kryetarët e fshatrave.

Drejtuesi i takimit publik:

Kryetari i këshillit Z. Dhimitër Kapaj

Nr.	Informacioni për publikun	Përshkrimi
1	Qëllimi i këshillimit publik	Nëpërmjet konsultimit dhe bashkëbisedimit me banorët dhe grupet e synuara Bashkia Himarë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve dhe rekomandimeve nga komuniteti lidhur me projektbuxhetin afatmesëm dhe atë të 2024.
2	Përshkrimi i çështjes që trajton projektakti	Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 18, dhe nenit 54 shkronja “e” të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, si dhe në zbatim të ligjit 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në ligjin 68/2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik” Këshilli Bashkiak Himarë do të organizojë seanca këshillimi dhe dëgjimi me qytetarët për diskutimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimin e buxhetit për vitin 2024, bashkia Himarë.
3	Projektakti dhe relacionin shoqërues	Lidhja e materialit, link nga webi
4	Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	A mendoni se prioritetet e parashikuara në këtë draft Program janë në përputhje me ato që ju konsideroni prioritete? Cilat janë sugjerimet tuaja për të përmirësuar/ndryshuar këtë draft Program? Cfarë konsideroni se duhet shtuar në këtë draft Program?
5	Grupet e interesit, strukturat komunitare me të cilat do të konsultohet projektakti	Qytetarë të Bashkisë dhe Njësive Administrative Himarë.
6	NjA, lagjet, fshatrat ku do të mbahen takimet publike apo që ftohen të dërgojnë komente dhe rekomandime	Bashkia Himarë, sipas kalendarit bashkëlidhur
7	Kalendari i takimeve dhe dëgjësave publike	Kalendari i datave, vendeve dhe orëve është i përcaktuar në kalendarin bashkëlidhur

		këtij njoftimi. Për cdo lloj komunikimi jeni të lutur të kontaktoni nëpërmjet e-mailit: bashkiahimare@yahoo.com elenaalikaj7@gmail.com
		Komentet dhe rekomandimet tuaja i mirëpresim brenda datës 31.10.2023: 2. Nëpërmjet pjesëmarrjes tuaj në dëgjesat publike , apo mund t'i dërgoni me e-mail në adresën: bashkiahimare@yahoo.com elenaalikaj7@gmail.com ose nëpërmjet postës në adresën: Adresa: L: "Spile", Himarë, tel: 039322355, fax: 039322533. www.bashkiahimare.gov.al
9	Çfarë do të vijojë pas kësaj faze këshillimi	Pas përfundimit të këtij konsultimi publik, Këshilli Bashkiak do të dërgojë tek Kryetari i Bashkisë dhe drejtoritë përkatëse një shkresë, me të gjitha rekomandimet e nxjerra nga kjo dëgjesë publike, me qëllim reflektimin e tyre.

KALENDARI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE ME QYTETARËT E BASHKISË HIMARË.

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE	DATA	ORA	VENDI
1	HOR-VRANISHT	24.10.2023	10:00	Pranë Njesisë Administrative
2	LUKOVË	25.10.2023	10:00	Borsh, pranë "Freskia"
3	HIMARË	26.10.2023	10:00	Salla e mbledhjeve

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Dhimitër Kapaj


